

\*\*\*\*\*

\*\*\*\*\*

**AKTI THEMELIMIT DHE STATUTI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“DP LAW STUDIO” sh.p.k**

\*\*\*\*\*

\*\*\*\*\*

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“DP LAW STUDIO” sh.p.k**

**KAPITULLI I  
FORMA, EMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA**

**Neni 1 – Forma**

- 1.1. Shoqëria **“DP LAW STUDIO” sh.p.k**, (në vijim “Shoqëria”) krijohet në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, dhe veprimtaria e saj rregullohet me anë të këtij Akti që përbën Aktin e Themelimit dhe Statutin njëkohësisht.
- 1.2. Shoqëria vepron sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 1.3. Ky akt është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe ka karakter të detyrueshëm, ndërsa çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në të, plotësohen nga legjislacioni shqiptar.

**Neni 2 – Emërtimi dhe Logo**

- 2.1 Emërtimi i Shoqërisë është **“DP LAW STUDIO” sh.p.k**,
- 2.2 **Logoja e Shoqërisë “DP LAW STUDIO”** është në formë katrore, ku brenda këtij katrori dallohen shkronjat “D” dhe “P” dhe në brendësi të shkronjave është emri “Drini Pira”. Poshtë këtij katrori gjendet e shkruajtur ”Law Studio”.

**Neni 3 – Objekti i shoqërisë**

- 3.1 Shoqëria **“DP LAW STUDIO” sh.p.k**, ka si objekt veprimtarie kryerjen e të gjitha veprimtarive që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të ligjit shqiptar brenda dhe jashtë territorit duke u kufizuar në vecanti:
  - 3.1.1 Mbrojtje ligjore dhe përfaqësim i posaçëm dhe i përgjithshëm përpara të gjitha shkallëve të procesit gjyqësor.
  - 3.1.2 Këshillim, përfaqësim dhe shërbime ligjore në fushën e legjislacionit civil, penal (gjatë kohës së shoqërimit, ndalimit, arrestimit, gjatë procesit të hetimit, shqyrtimit gjyqësor), administrativ, të punës, doganor, bankar dhe atij fiskal.
  - 3.1.3 Këshillim, përfaqësim dhe shërbime ligjore brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si shoqëri apo në bashkëpunim me studio ligjore apo avokatë.
  - 3.1.4 Konsulencë juridike në lidhje me formën ligjore të lindjes, ndryshimit, shuarjes së marrëdhënieve juridike të detyrimit apo atyre kontraktorë.
  - 3.1.5 Këshillim, përfaqësim dhe shërbime ligjore për persona fizikë apo juridikë,

shqipëtarë apo të huaj (klient) në çështjet civile, penale dhe administrative, në gjykatë, në arbitrazh dhe në organe të tjera të administratës publike.

3.1.6 Përpilim, hartim, rishikim, kontrollim të dokumentacionit të nevojshëm dhe/ose depozitim në institucionet përkatëse dhe/ose ndjekje të procedurave ligjore, sipas çështjes konkrete të klientit (kërkesëpadi apo akte të tjera juridike, prokura për përfaqësim të subjekteve të interesuara, dokumente për regjistrim të shoqërive tregtare, dokumente të shoqërive tregtare të regjistruar si subjekte të së drejtës shqiptare apo të huaj, për ndryshimet e administratorëve, të ortakëve, ndryshimin e kapitalit, transferimin e kuotave, ndryshim statuti etj., kërkesa apo ankesa drejtuar institucioneve përkatëse, akte që i nënshtrohen veprimeve noteriale).

3.1.7 Konsulencë juridike për çështjet e trashëgimisë ligjore dhe testamentare, përfaqësim në gjykatë për çeljen e trashëgimisë ligjore, kundërshtim të testamentit etj.

3.1.8 Përpilim kontratash të të gjitha llojeve, përfshirë këtu edhe kontratat aksesore si mjete të sigurimit për përmbushjen e detyrimeve, si dhe të çdo dokumenti tjetër që sjell ose synon të sjellë pasoja juridike.

3.1.9 Ndjekje të procedurave të nevojshme për ekzekutimin e titujve ekzekutiv pranë Zyrave të Përmbartimit, deri në ekzekutimin e plotë të detyrimit.

3.1.10 Cdo veprimtari tjetër të dobishme në interes të shoqërisë.

#### **Neni 4 – Selia**

4.1 Selia e Shoqërisë është në adresë: Rruga "5 Maji" Pallati 36, Shk.17, Ap.5, Tiranë.

4.2 Asambleja e Ortakëve mund të vendosë hapjen e filialeve, degëve dhe përfaqësive të Shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë si edhe jashtë saj.

#### **Neni 5 – Kohëzgjatja e veprimtarisë**

5.1 Shoqëria krijohet për një afat të pacaktuar.

### **KAPITULLI II KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA E PJESËVE TË KAPITALIT**

#### **Neni 6 – Kapitali themeltar**

6.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 (një qind) lekë.

6.2 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet me 1 kuote me vlerë nominale 100 (një qind) lekë.

#### **Neni 7 - Kontributet**

7.1 Kontributi në kapitalin e shoqërisë është ofruar si më poshtë:

- Shtetasi Drini Pira, ka ofruar një kontribut në para të barabartë me lekë 100 (një qind) lekë, në favor të shoqërisë në themelimin e sipër **DP LAW STUDIO sh.p.k** qe përbën 1 kuotë;

7.2 Sipas kontributit të mësipërm:

- Z. Drini PIRA i perket 1 pjese/kuote që përbëjnë 100 % të kapitalit themeltar të Shoqërisë;

### **Neni 8 – Rritja e kapitalit themeltar**

- 8.1 Kapitali themeltar mund të rritet pa kufi në çdo moment, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Ortakëve.
- 8.2 Në rast rritjeje të kapitalit, ortakët kanë të drejtën të nënshkruajnë rritjen në raport me pjesët e kapitalit të zotëruara.

### **Neni 9 – Zvogëlimi i kapitalit themeltar**

- 9.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar me vendimin e Asamblesë së Ortakëve. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.
- 9.2 Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga ortakët në të njëjtën masë me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre.

### **Neni 10 – Transferimi i pjesëve të kapitalit dhe e drejta e parablerjes**

- 10.1 Pjesët e kapitalit janë lirisht të transferueshme.
- 10.2 Në rast transferimi të pjesëve të kapitalit në çdo lloj forme në favor të personave të tjerë nga ata të parashikuar më sipër, si me shpërblim ashtu edhe pa shpërblim, me çdo kusht, duke përfshirë edhe dhurimin, ortakët e tjerë gëzojnë të drejtën e parablerjes mbi këto pjesë kapitali.
- 10.3 Në një rast të tillë ortaku që do të transferojë pjesët e tij të kapitalit duhet t'i njoftojë ortakët e tjerë, me letër rekomande, mbi synimin për shitjen, çmimin, kushtet, modalitetet, emrin e blerësit dhe afatet e transferimit. E drejta e parablerjes i referohet të gjitha pjesëve të kapitalit ofruar për shitje.
- 10.4 Ortakët do të kenë në dispozicion 30 (tridhjetë) ditë nga marrja e letrës rekomande, për t'i komunikuar ortakut që transferon pjesët e kapitalit, synimin e tyre për të ushtruar apo jo të drejtën e parablerjes. Në rast se ata nuk përgjigjen në afatin e caktuar, prezumohet se kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes.
- 10.5 Në rast se oferta pranohet nga disa ortakë, pjesët e kapitalit të ofruara nga ortaku që transferon pjesët e kapitalit, do të ndahen nga ortakët pranues, në të njëjtën masë më pjesët që ata zotërojnë, përveç rastit kur ka një marrëveshje të kundërt. Në asnjë rast, pranuesi i ofertës nuk mund të ushtrojë pjesërisht të drejtën e parablerjes.
- 10.6 Në rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, pjesët e kapitalit mund t'i transferohen të tretëve plotësisht apo pjesërisht, me vendimin e Asamblesë që përfaqëson të paktën  $\frac{3}{4}$  (tre të katrat) e kapitalit themeltar, në përputhje me Ligjin Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare.
- 10.7 Pjesët e kapitalit të Shoqërisë janë të transferueshme për shkak trashëgimie *mortis causa*. Në rast të vazhdimit të Shoqërisë me disa trashëgimtarë të ortakut të vdekur, trashëgimtarët duhet të emërojnë një përfaqësues të përbashkët.
- 10.8 Në rast të transferimit të pjesëve të kapitalit për shkak trashëgimie *mortis causa*

ortakët e tjerë kanë të drejtë të shprehin pëlqimin e tyre për ortakët e rinj sipas modaliteteve të parashikuara në Ligjin Per tregetaret dhe Shoqerite Tregetare.

### **KAPITULLI III ASAMBLEJA, ADMINISTRATORËT DHE EKSPERTI KONTABËL**

#### **Neni 11 – Asambleja e ortakëve dhe kompetencat e saj**

- 11.1 Organi vendim-marrës i Shoqërisë është Asambleja e Ortakëve
- 11.2 Vendimet e Asamblesë duhet të miratohen, si në mbledhjen e parë ashtu edhe në atë vijuese, nga ortakët.

#### **Neni 12 – E drejta e pjesëmarrjes dhe e votës**

- 12.1 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në Asamble, të paraqesë mendimin e tij dhe të japë aq vota sa është numri i pjesëve të kapitalit që ai zotëron. Nje pjese eshte e barabarte me nje vote.
- 12.2 Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër jo-ortak, i pajisur me prokurë me shkrim, me anën e së cilës mund të japë votën e tij.
- 12.3 Ortaku nuk mund të lëshojë prokurë për votim për një pjesë të kapitalit që zotëron, në qoftë se voton personalisht për pjesën e mbetur.

#### **Neni 13 – Thirrja e Asamblesë së Ortakëve**

- 13.1 Asambleja e Ortakëve thirret të paktën një herë në vit, brenda afateve ligjore për miratimin e bilancit, të raportit të Administratorit.
- 13.2 Asambleja mund të thirret në çdo moment nga Administratori ose nga likuidatori/likuidatorët si dhe prej një ose disa ortakëve që zotërojnë jo më pak se 5% të kapitalit themeltar.
- 13.3 Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga akt themelimi e statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.  
Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 13.3 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.
- 13.4 Kërkesa nga ortakët e pakicës:
  - a. Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë, apo një pjesë më të vogël të parashikuar në akt themelimi e statut, mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin

asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës, në përputhje me pikën 13.3 të këtij neni.

b. Nëse, në kundërshtim me pikën 13.4/a të këtij neni, asambleja e përgjithshme nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë:

- i) të ngrejë padi në gjykatë, për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse administratorët nuk përmbushin kërkesat e ortakëve brenda 15 ditëve;
- ii) t'i kërkojë shoqërisë blerjen e kuotave, të zotëruara prej tyre.

c. Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, sipas parashikimeve të pikave 13.4/a/b të këtij neni dhe thirrja i është njoftuar ortakëve, administratorët njoftojnë përsëri rendin e ditës, të ndryshuar, në përputhje me parashikimet e pikës 13.3 të këtij ligji.

- 13.5 Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethanë, të tillë që, sipas gjykimit të ortakut të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimmarrjen e përfaqësuesit për interesa të tjerë të ndryshëm nga ata të ortakut të përfaqësuar.
- 13.6 Vendimet e Asamblesë duhet të nënshkruhen nga ortakët dhe nga Sekretari.

#### Neni 14 – Administrimi

- 14.1 Shoqëria mund të administrohet nga të paktën 1 (një) Administrator, i cili qëndron në detyrë deri në revokimin apo dorëheqjen ose deri në afatin e caktuar nga Asambleja në aktin e emërimit.
- 14.2 Administrator i shoqërisë emërohet **Znj. Xhulia SHESHI** e bija e Enver, lindur dhe banuese në Tiranë, e datelindjes 03.08.1996, me adrese ne: Rr. “Thoma Filipeu”, Kompleksi “Destaxhej”, Ap. 21, identifikuar me letërnjoftim me Nr.032731825 dhe me Nr.Personal J65803066Q , e cila qëndron në detyrë për një periudhë 4 – vjecare.
- 14.3 Administratori zotëron kompetenca te plota ne lidhje me administrimin e shoqërisë dhe mund te kryeje te gjitha aktet qe konsideron te nevojshme per realizimin e objektit te shoqerise perves kur ky akt themelimi e statu ose ligji ja rezervon Asamblese se Pergjithshme apo organeve te tjera te shoqerise.
- 14.4 Administratori është përgjegjes për veprimet e kryera ne administrimin e shoqerise.
- 14.5 Administratori duhet të veprojë gjithmonë në interes të shoqërisë. Në rast konflikti interesi, Administratori duhet të njoftojë menjëherë ortakun e shoqërisë si dhe heq dorë nga çdo veprim që lidhet me objektin e konfliktit të interesit deri në marrjen e udhëzimeve nga Asambleja e Përgjithshme.
- 14.6 Administratori do të marri vendime në lidhje me çështjet e mëposhtme vetëm pas marrjes së miratimit paraprak nga Asambleja e Përgjithshme:
  - blerja, shitja, vendosja e barrëve, likuidimi, dhe terhecja e pjesëmarrjes në shoqeri;
  - blerja, shitja dhe vendosja e barrëve mbi pasuri te paluajtshme;
  - huamarrjet per cdo lloj detyrimi, hua, apo kreditime, si dhe pranimet e pergjegjesive mbi detyrimet, huatë dhe kreditë
  - investime;
  - miratimi i dhenies se huave, me perjashtim të atyre huave te cilat akordohen gjate rrjedhes se zakonshme të biznesit;
  - përcaktimi i parimeve te pergjithshme të politikave të biznesit;
  - përcaktimi i parimeve të përgjithshme në lidhje me akordimin e incentivave si pjesëmarrjet në fitime apo shitjet dhe angazhimi në

- skemat e pensioneve per drejtorët ekzekutivë të Shoqërisë;
- akordimi i të drejtave mbi aksionet në Shoqëri tek punemarresit dhe drejtorët ekzekutivë të Shoqërisë, apo tek cilado dege e saj;
- miratimi i marrëveshjeve të lidhura ndërmjet Shoqërisë dhe Administratorëve;
- autorizimi i lëshimit të cfarëdo titulli të kapitalit, apo të drejtave në lidhje me të, duke përfshirë por pa u kufizuar tek vendosja e kushteve për blerjen e aksioneve, garantimin e aksioneve, dhe të titujve të konvertueshme apo të kthyeshme në aksione;
- lidhja e çdo lloj transaksionesh me cilindo prej drejtoreve të Shoqërisë, ose me ndonjë pale të lidhur me këta persona;
- kryerja apo zbatimi i ndonjë ndryshimi në cilindo prej parimeve të kontabilitetit apo praktikave të Shoqërisë, apo metodës sesi mbahen librat dhe regjistrat e Shoqërisë, me përjashtim nëse parashikohet ndryshe nga ligji, aktet normative, apo praktika profesionale;
- kryerja e një veprimi në përfitim të kreditorëve, apo depozitimi i një peticioni falimentimi apo paaftësie pagese, apo çdo procedim i ngjashëm në lidhje me Shoqërinë;
- lidhja e transaksioneve derivate;
- miratimi i planeve të biznesit dhe të investimeve.

14.7. Asambleja e Përgjithshme përcakton shpërblimin e Administratorëve të Shoqërisë.

14.8 Detyra e Administratorit përfundon në rast se:

- (a) personi nuk gëzon cilësinë e Administratorit sipas parashikimeve të ligjit;
- (b) personi ndodhet në gjendje paaftësie pagese apo kryen veprime gjate administrimit që cojnë në paaftësi pagese të shoqërisë ;
- (c) personi vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;
- (d) personi jep doreheqjen nga detyra duke njoftuar Shoqërinë dhe Asamblenë.

#### **Neni 15 – Eksperti kontabël i autorizuar**

- 15.1 Në rast se kërkohet nga ligji apo vendoset nga Asambleja e Ortakëve, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabël të Shoqërisë mund t'i besohet një eksperti kontabël të autorizuar, i cili mandatohet në vendimin e emerimit.
- 15.2 Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet sipas mënyrës së parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

### **KAPITULLI IV VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE**

#### **Neni 16 - Viti financiar dhe bilanci vjetor**

- 16.1 Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të secilit vit.
- 16.2 Viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (Q.K.B.) dhe përfundon më 31 dhjetor të të njëjtit vit.
- 16.3 Bilancet vjetore, inventari, raportet e Administratorit dhe ekspertit kontabël të autorizuar (nëse është emëruar) miratohen nga Asambleja.

- 16.4 Miratimi i dokumentave që lidhen me vitin financiar duhet të bëhet brenda 6 (gjashtë) muajve që nga fundi i vitit financiar.

#### **Neni 17 – Fitimet**

- 17.1 Fitimet që rezultojnë nga bilanci vjetor, duke zbritur 5% (pesë për qind) që caktohen për rezervën ligjore deri në 10% (dhjetë për qind) e kapitalit themeltar, dhe duke zbritur gjithashtu të gjitha shumat që Asambleja vendos t'i vërë mënjanë, u shpërndahen ortakëve në proporcion me pjesët e kapitalit themeltar të zotëruara.
- 17.2 Asambleja mund të vendosë edhe zbritje të veçanta në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo dhe shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet financiare të ardhshme.

### **KAPITULLI V SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË**

#### **Neni 18 – Prishja**

- 18.1 Shoqëria priset me përfundimin e afatit të parashikuar, ose përpara përfundimit në rastet e parashikuara nga ligji, ose me anë të një vendimi të Asamblesë së Ortakëve.
- 18.2 Shoqëria nuk priset në rast të humbjes së zotësisë për të vepruar, pazotësisë juridike, vdekjes, ose falimentimit të ortakut-ortakëve.

#### **Neni 19 – Likuidimi**

- 19.1 Në rast prishje, Shoqëria duhet të likuidohet.
- 19.2 Për të administruar këtë procedurë, Asambleja emëron një ose më shumë likuidatorë, të cilët paraqesin raportet përfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të Shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.
- 19.3 Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Asambleja do të vendosë mbi bilancin financiar përfundimtar, mbi punën e kryer nga likuiduesi dhe mbi përfundimin e procesit të likuidimit.
- 19.4 Pas pagimit të kreditorëve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori do t'i shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likuidimit ortakëve, në proporcion me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre në kapitalin themeltar.

#### **Neni 20 - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

- 20.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij akti të themelimit e statuti, si edhe ato që mund të lindin në përgjithësi midis ortakëve (përveç atyre personale apo jashtë Shoqërisë) ose midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.
- 20.2 Në rast se mosmarrëveshjet nuk zgjidhen në mënyrë miqësore midis ortakëve, atëherë kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqsor Tirane.



**Neni 21 – Gjuha**

- 21.1 Ky Akt themelimi dhe Statut është hartuar në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe.
- 21.2 Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij Akt Themelimi e Statuti, versioni në gjuhën shqipe do të jetë i vetmi ligjrisht detyrues.
- 21.3 Administratori autorizon **Z. Drini PIRA** i biri Agim, i datëlindjes 06.07.1990 identifikuar me letërnjoftimin me Nr.032163471 dhe Nr.Personal J00706074D për të kryer të gjitha procedurat e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Ky Akt Themelimi dhe Statut nënshkruhet lirisht nga Administratori dhe Ortaku i Shoqërisë.

Lexuar, kuptuar dhe nënshkruar

Tirane, më 04/02/2021

**ORTAKU I SHOQËRISË “DP LAW STUDIO” sh.p.k**

**Drini PIRA**

**ADMINISTRATORI I SHOQËRISË ”DP LAW STUDIO” sh.p.k**

**Xhulia SHESHI**